



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok.202101115/4

Tiranë ____/____/2021

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për respektimin e afateve procedurale për arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore.*

GJYKATËS SË APELIT SHKODËR

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar dy ankesa të paraqitura nga shtetasi G.P. Fillimisht, nga ky shtetas është pretenduar zvarritje e afatit për shqyrtimin e çështjes gjyqësore nga Gjykata e Apelit Shkodër.

G.P gjendej në një proces gjyqësor për zgjidhje martese me shtetasen J.P, çështje e cila është regjistruar në Gjykatën e Apelit Shkodër me nr.***** në datën 01.02.2019 dhe gjendej në statusin, në përpunim në gjykatë.

Pas komunikimit ndërmjet institucionit tonë me Gjykatën e Apelit Shkodër dhe bashkëpunimit me këtë organ, u bë i mundur caktimi i një date për shqyrtimin e çështjes në fjalë.

Në vijim, në muajin shtator 2021 është paraqitur një ankesë e re nga ky shtetas, në të cilën ngrihen pretendime mbi mosdorëzimin në sekretari të vendimit gjyqësor brenda afatit të përcaktuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile. Ankuesi është shprehur se nga data 10.05.2021 (data e shpalljes së vendimit) e deri më datë 03.09.2021 kur ai ka paraqitur ankesën pranë Avokatit të Popullit, nuk i ishte njoftuar vendimi i arsyetuar, duke i sjellë kështu pengesë për lidhjen e një martese të re.

Në llogaritje të vonesës, duke zbritur muajin gusht që ka qenë muaj i pushimeve vjetore, jemi interesuar për këtë rast, në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me shkresën nr.1668/1, datë 24.09.2021, sqaron se:

*“Në Gjykatën e Apelit Shkodër është regjistruar çështja me numër: *****; Numri i Aktit: ***; Kategoria e çështjes: Civile Themeli/Familjare, me titull: **** (paditës) kundër **** (i paditur), me objekt: Padi për zgjidhje martese.*

Vendimi nr.173, datë 10.05.2021 është dorëzuar në sekretari më datë 17.09.2021. Ankuesit iu komunikua në datë 17.09.2021, me dëftesë komunikimi.

Në bazë dhe në zbatim të Kodit të Procedurës Civile, neni 443 afati i ankimit (ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.05.2001, neni 72, 126, neni 444 fillimi i afateve të ankimit i ndryshuar), ...ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit.

Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda afatit ligjor 30 ditë nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

*Dëftesa e komunikimit të vendimit të arsyetuar është më datë 17.09.2021. Shtetasi **** nuk ka pengesa ligjore në ushtrim të të drejtave materiale dhe procedurale të ankimit të vendimit apo të drejta të tjera ligjore.”*

Dëshirojmë të shprehim vlerësim për bashkëpunimin shumë të mirë të deritanishëm ndërmjet institucioneve tona, si dhe për ta vijuar më tej atë.

Ndërkohë, evidentojmë se në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet shprehimisht:

“Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Gjyqtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin. Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në njëzet ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër.”

Po ashtu, në nenin 316 të këtij Kodi parashikohet:

“Vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tre ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar. Njoftimi bëhet sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I.”

Parashikimet për arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve gjyqësore janë edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.¹

¹ Nenet 382 dhe 386 të Kodit të Procedurës Penale:

1. Pas marrjes së vendimit bëhet arsyetimi i tij duke u bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
2. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë **brenda 30 ditëve nga shpallja e tij**. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
3. Kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
4. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës.

Nga ana tjetër, Kodi i Procedurës Civile, i cili përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera, me ndryshimet e vitit 2017, i ka kushtuar vëmendje të veçantë çështjes së respektimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit, duke e trajtuar këtë institut në një kre të veçantë. Në dispozitën e nenit 399/2, pika 1 të kodit përcaktohet se:

“1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

a) në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë;

b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve;

c) në procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë, afati njëvjeçar fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënie në ekzekutim;

ç) në hetimin e veprave penale afati maksimal i kohëzgjatjes së hetimeve, sipas Kodit të Procedurës Penale;

d) në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjykimit të krimeve 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit, në gjykimin në apel përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj dhe në Gjykatën e Lartë, përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj.”

Në vlerësim të Avokatit të Popullit, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore të qytetarëve. Për këtë arsye, e drejta e gjykimit

1. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas arsyetimit, brenda afateve të parashikuara në nenin 382 të këtij Kodi. Nënuesi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimit.

2. Vendimi u njoftohet palëve në adresën e deklaruar prej tyre. Njoftimi i kryer në adresën e deklaruar nga palët konsiderohet i realizuar.

brenda një afati të arsyeshëm nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është standard kushtetues, i garantuar dhe sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar (neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), ashtu edhe në të drejtën e brendshme (neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë²).

Neni 6 i KEDNJ³ zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e të drejtave që garanton kjo konventë. Një gjykim i drejtë në çështje civile dhe penale është një element bazë i parimit të shtetit të së drejtës. Midis garancive që lidhen direkt ose indirekt me gjykatën janë ndër të tjera: publiciteti i gjykimit (seancat e hapura dhe shpallja e vendimit publikisht), mënyra e zhvillimit të rregullt të seancave gjyqësore, konkretisht elementë të tillë si: barazia e armëve, *afati i arsyeshëm, arsyetimi i vendimeve* etj.

² Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

³ Sipas nenit 6 “E drejta për një proces të rregullt” të KEDNJ-së:

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.
3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
 - a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishtme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
 - b) t’i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
 - c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
 - d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
 - e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Problematika e shpalljes me vonesë të vendimeve gjyqësore ka gjetur trajtim në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë⁴. Po ashtu, kjo çështje është trajtuar në vijimësi edhe nga Gjykata Kushtetuese⁵.

Këto gjykata kanë theksuar se mosshpallja e vendimeve brenda afateve të arsyeshme bie në kundërshtim me ligjin procedural dhe cenon të drejtën kushtetuese të të gjykuarit për ankim dhe akses në gjykatë, për shkaqe që rrjedhin nga gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore. **Kështu, shpallja e vendimit përfundimtar të arsyetuar është detyrim ligjor me pasojë pavlefshmërinë e tij.**

Po sipas jurisprudencës vendase, **arsyetimi ligjor i vendimit është një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor** i cili ka për qëllim:

- a) *ushtrimin e kontrollit gjyqësor nga një gjykatë më e lartë dhe*
- b) *ushtrimin e kontrollit publik në administrimin e drejtësisë.*

Të dy këta elementë lidhen ngushtësisht me të drejtën e ankimit të subjektit procedural, pasi kontrolli gjyqësor nuk ushtrohet në mënyrë incidentale, por mbi bazën e shkaqeve të ngritura nga palët në proces.

Kufizimi në kohë i së drejtës së ankimit lidhet me përcaktimin, jo vetëm të detyrimit të gjykatës për ta arsyetuar vendimin përfundimtar, por edhe dorëzimin e vendimit në sekretarinë gjyqësore.

Një zgjatje e tepruar nga seanca e fundit deri në nxjerrjen e një vendimi të arsyetuar mund të cenojë të drejtën e gjykimit pa vonesa të panevojshme dhe të pengojë mundësinë e palëve për të ushtruar në mënyrë të efektshme të drejtën e ankimit. Në rastin e Shqipërisë kjo e drejtë është e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës.

⁴ Vendimet e Gjykatës së Lartë me nr. 38/2013 dhe nr. 84/2013; Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara nr.5, datë 12.12.2013.

⁵ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 5/2011.

Në rastin e paraqitur, mosnjoftimi në kohë i vendimit të arsyetuar të formës së prerë ankuesit dhe moskomunikimi i këtij vendimi Zyrës së Gjendjes Civile përkatëse për pasqyrimin e ndryshimeve, ka sjellë si pasojë vazhdimin e marrëdhënies së parë juridiko civile me ish bashkëshorten, duke e penguar ankuesin të lidhë një martesë të re.

Në referim të vendimeve të GJEDNJ⁶, por edhe praktikës së saj në përgjithësi “case law”, gjykatat vendase kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm “*të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshem*”. Sa më sipër, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, ky parim garanton mbrojtjen e të gjitha palëve të përfshira në procesin gjyqësor ndaj “*vonesave të tepruara procedurale*”, që në administrimin e drejtësisë rrezikojnë të drejtat e palëve dhe shtetin e së drejtës. Një drejtësi jo efikase dhe e vonuar çon në dëmtimin e besimit të qytetarëve tek institucionet e shtetit. Drejtësia e vonuar është e njëjtë me drejtësinë e mohuar (Magna Carta). Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar. Siç edhe është parashtruar më sipër në këtë vendim, në çështjet gjyqësore periudha e arsyeshme që merret në konsideratë për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor fillon me ngritjen e padisë dhe përfundon kur vendimi i arsyetuar merr formë të prerë.

Në çështjen *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, GJEDNJ-ja doli në përfundimin se mosdhënia e një vendimi të arsyetuar për të akuzuarin në kohën e duhur, nuk i dha atij mundësi (kohe dhe mjete të mjaftueshme) të paraqiste argumentet e tij për t’u ankuar në Gjykatën e Kasacionit. Kjo cenoi të drejtën për një gjykim të drejtë. Mosdhënia nga ana e gjykatës e vendimit të arsyetuar me shkrim, brenda një kohe të arsyeshme, solli si pasojë

⁶ PGV kundër Italisë, vendimi i GJEDNJ, datë 7.11.2000; **Çështja X kundër Francës, 1998**; Vocaturò kundër Italisë; Cappello kundër Italisë; Darvan kundër Turqisë, 2009; Zimmermann dhe Steinner kundër Zvicrës, datë 13.06.1983; Vendimi K.Klitshe de la Grande kundër Italisë, 27.10.1994; Poiss kundër Austrisë, datë 23.04.1097. Vendimi “Hadjianastassiou kundër Greqisë, 16.12.1992

moslejimin e të paditurit për të ushtruar në mënyrë të efektshme të drejtën e tij, sipas legjislacionit vendas për rishikimin e vendimit nga një gjykatë më e lartë.

Ndryshe nga vonesat në procesin gjyqësor, ku palët kanë ndikim shumë të shprehur, **arsyetimi dhe dorëzimi i vendimit gjyqësor implikon vetëm gjyqtarin**. Këtu gjyqtari është përballë vetvetes dhe përgjegjësia për vonesa është vetëm e tij. Gjyqtarët kanë detyrimin ligjor për respektimin e të drejtave të garantuara nga neni 6 i KEDNJ-së dhe legjislacioni i brendshëm lidhur me gjykimin e drejtë, si dhe është thelbësore të ruhet dhe të rritet besimi i qytetarëve tek gjykata dhe sistemi gjyqësor në përgjithësi.

Në Kodin e Procedurës Civile të RSH, ashtu si disa legjislacione evropiane, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga GJEDNJ, janë parashikuar edhe mjete të veçanta ankimi, me qëllim përshpejtimin e proceseve gjyqësore. Një nga këto mjete është edhe padia e veçantë e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile lidhur me zgjatjen e procesit tej afatit të arsyeshëm. Me anë të këtij ankimi pala e interesuar ka mundësinë për të ndikuar drejtpërdrejt në një përshpejtim të procesit. Me anë të kësaj padie, qytetari jo vetëm konstaton tejzgjatjen pa arsye të procesit, por mund të marrë dhe dëmshpërblim (nëse e kërkon) për vonesën e shkaktuar. Vendimi në këtë rast urdhëron gjykatën kompetente ta shqyrtojë çështjen sa më parë. Natyrisht, në disa raste tejzgjatja e procesit gjyqësor ka shkaqe objektive. Në një rast të tillë kjo padi mund të bëhet shkak për evidentimin e arsyeve konkrete dhe ndoshta edhe për eliminimin e tyre nga organet kompetente. Pra, ky mjet duhet konsideruar me efekt parandalues, në rast të tejzgjatjes pa shkak të procesit, pra që çdo individ ka një mjet efikas që do t'i vijë në ndihmë.

Sjellim në vëmendje që në muajin tetor 2021, GJEDNJ ka vendosur për rastin e dy kërkuesve, *Bara and Kola v. Albania*, shtetas shqiptarë që janë ankuar pranë këtij institucioni për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore në Shqipëri. Kjo Gjykatë ka

vendosur se në këto raste është shkelur e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.⁷

Duke mos shpërfillur vonesën e kuptueshme që rrjedh nga reformat e thella të sistemit të drejtësisë dhe procesi i vettingut, Gjykata ripohoi se shtetet kishin një detyrim të përgjithshëm për të organizuar sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të siguronin përputhjen me kërkesat e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës, duke përfshirë atë të një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.

Së fundmi, ndonëse nuk i takonte Gjykatës të vendoste për interpretimin e duhur të ligjit të brendshëm, ajo konsideroi se qasja e Gjykatës së Lartë në çështjen e aplikantit të parë për të mosllogaritur efektet e reformave të vazhdueshme të sektorit të drejtësisë në funksionimin e tij në shtrirjen e përgjithshme të procedurave, në këto rrethana, nuk do të ishin në përputhje me jurisprudencën e saj sipas nenit 6 paragrafi 1 mbi kërkesën e “*afatit së arsyeshëm*”, pasi mund të zhvendoste tek palët ndërgjyqëse individuale barrën e plotë të çdo vonese të shkaktuar nga reformat në sektorin e drejtësisë.

Përveç kësaj, u konstatua se mjeti i ri juridik sipas Kodit të Procedurës Civile, i miratuar në vitin 2017, nuk kishte ndihmuar në përshpejtimin e gjykimeve, duke mos i lënë ankuesit të parë asnjë mjet juridik në dispozicion për t'u marrë me shkeljen e të drejtave të tij sipas nenit 6 paragrafi 1. Megjithatë, Gjykata deklaroi se mjeti i ri juridik është në parim i pajtueshëm me nenin 13 dhe për këtë arsye duhet të shterret përpara se të paraqiten ankesa të ngjashme në Gjykatë.

Dispozitat e kodeve procedurale kanë si qëllim vendosjen për herë të parë të standardeve, si dhe një kufi në raport me termat kohorë lidhur me gjykimin brenda afatit të arsyeshëm, si dhe arsyetimin e vendimeve.

⁷ *Bara and Kola v. Albania* - [43391/18](#) and [17766/19](#), Judgment 12.10.2021.

E drejta e gjykimit brenda një afati të shpejtë dhe të arsyeshëm është jo vetëm një garanci për mbrojtjen e palëve nga zvarritjet e paarsyeshme të procedurave, por mbi të gjitha garanton se brenda një afati të arsyeshëm, pala kërkuese do të përfitojë eventualisht nga të drejtat që i janë mohuar, duke i mundësuar asaj siguri juridike në raport me pozitën procedurale. Për më tepër, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, përveçse është një standard të cilin organi gjyqësor ka detyrimin ta respektojë *apriori*, është mbi të gjitha një standard që vlerësohet në mënyrë të veçantë për secilin rast konkret, nisur nga specifika, kompleksiteti, tërësia e të drejtave të shkelura apo të pretenduara, etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson faktin se në gjykata aktualisht ka një numër të konsiderueshëm të çështjeve të paraqitura për gjykim, gjë që çon në ngarkesë voluminoze të punës së gjyqtarëve, shoqëruar kjo edhe me vakancat e shkaktuara si rrjedhojë e procesit të vettingut, por nga këndvështrimi i Avokatit të Popullit kjo barrë kurrsesi nuk mund t'u ngarkohet shtetasve.

Sigurisht, që reforma e vettingut e ka përballur sistemin gjyqësor me shumë vështirësi, për arsye të procesit të zgjatuar, ritmeve të ngadalta, me vonesa të panevojshme dhe me sfida të mëdha sociale dhe profesionale.

Gjithashtu, duke iu kushtuar një rëndësi thelbësore përjashtimit nga sistemi të individëve që nuk plotësojnë njërin ose disa prej tre kriterëve kushtetuese, janë lënë jashtë vëmendjes aspektet e tjera të rëndësishme të reformës, sikurse janë prurjet e reja në sistem, karriera, përmirësimi i cilësisë së punës në dhënien e drejtësisë, transparenca, rritja e pavarësisë dhe profesionalizmi.

Në veçanti, ngarkesa e punës në gjykatat e apelit është e madhe, ku po punohet me mungesa të theksuara në staf. Gjykata e Apelit Shkodër është një nga këto, e cila e plotëson numrin e trupave gjyqësore, me gjyqtarë nga gjykatat e apelit në rrethe të tjera për gjykimin e çështjeve. Mesatarja e gjykimeve në Gjykatën e Apelit Shkodër është relativisht më e lartë se në shumë gjykata të tjera në shkallë vendi.

Pandemia Covid-19 ka krijuar sfida të jashtëzakonshme për të gjithë autoritetet shtetërore dhe gjyqësore. Sistemi gjyqësor sikurse të gjithë institucionet publike në vendin tonë u përball me vështirësi të reja, krahas atyre me të cilat është hasur ky sistem vitet e fundit për arsye të procesit të vettingut. Sigurisht, pezullimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me përjashtim të çështjeve me natyrë të ngutshme, për një periudhë të gjatë 3 mujore solli si pasojë zvarritje të proceseve gjyqësore, shtyrje të gjykimit të çështjeve të reja, si dhe problematika në respektimin e plotë të të drejtave procedurale gjatë gjykimit.

Duke vlerësuar punën e bërë deri tani nga Gjykata e Apelit Shkodër, mbetet detyrimi i të gjithë anëtarëve të sistemit të drejtësisë rritja e besimit te sistemi.

Kështu, çmojmë se gjykimi i çështjeve në kohë, arsyetimi i vendimeve, si dhe dorëzimi i tyre brenda afateve procedurale, nevojitet të adresohen. Në këtë rast, konstatojmë se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2020 për Shqipërinë vihet në dukje se nevojiten përpjekje të mëtejshme në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit, monitorimin dhe raportimin e progresit për zbatimin e të drejtave të parashikuara në kodet procedurale pas reformës në drejtësi.⁸

Për gjithë sa parashtroam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: *“Avokati i Popullit paraqet*

⁸ SWD(2020) 354, Bruksel, 6.10.2020.

rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”:

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave për respektimin e afateve të përcaktuara në kodet procedurale lidhur me dorëzimin e vendimeve të arsyetuara nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi